



World Vision®



UDHËZUES ORIENTUES, PËR VETËVLERËSIMIN E SHKOLLËS QENDËR KOMUNITARE



UDHËZUES ORIENTUES PËR MËSUESIT, NXËNËSIT, PRINDËRIT, PËR *VETËVLERËSIMIN E SHKOLLËS QENDËR KOMUNITARE

Udhëzuesi është përgatitur me mbështetjen e organizatës World Vision në Shqipëri në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Arsimit, si dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Për hartimin e këtij udhëzuesi punuan:

Brisida Jahaj, Donika Qelemeni dhe Erjon Elmazi nga World Vision (WV)

Irida Sina, Albana Markja, dhe Evis Mastori nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA)

Tatjana Vucani nga Ministria e Arsimit dhe Sportit

Redaktore letrare: Ortensa Marini

Punimi grafik: Expressprint

Shtypi: ExpoVision

<http://wvi.org/albania>

izha.edu.al

shqk.edu.al

* Në këtë kontekst, fjala vetëvlerësim është përdorur për të theksuar faktin që Shkolla Qendër Komunitare vlerësohet nga vetë nxënësit, prindërit dhe mësuesit.

Botimi i këtij udhëzuesi u mundësua nga World Vision.

World Vision International është një organizatë e krishterë, humanitare, zhvillimi dhe advokimi, e themeluar në vitin 1950.

World Vision punon për të krijuar ndryshime të qëndrueshme në jetën e fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve që jetojnë në varfëri dhe padrejtësi. World Vision punon në 100 vende të botës. World Vision u përgjigjet nevojave në komunitet, pavarësisht nga raca, gjinia, prejardhja etnike dhe besimi fetar i pjesëtarëve të komunitetit. World Vision filloi programet në Kosovë dhe në Shqipëri respektivisht në vitet 1998 dhe 1999. Që atëherë, fokusin e vet e ka zhvendosur te zhvillimi dhe mbështetja afatgjatë për fëmijët dhe të rinjtë më në nevojë. World Vision Albania punon në tri fusha programatike: mbrojtja e fëmijëve, të rinjtë dhe edukimi.

Ky udhëzues publikohet në kuadër të projektit të Edukimit, i cili synon që fëmijët 6 -16 vjeç, veçanërisht ata me në nevojë, të gëzojnë edukim gjithëpërfshirës në një shkollë miqësore.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij dokumenti mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të arsimit apo mësuesve për trajnime apo zhvillim praktikash arsimore, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e World Vision-it dhe IZHA-s si burim.

Tiranë, 2016

Mirënjohje dhe falënderime!

Ky udhëzues vjen sot në formën e tij më të plotë falë ekspertizës dhe kontributit të vyer të specialistëve të Insitutit të Zhvillimit të Arsimit, mbështetjes së vazhdueshme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe aktiviteteve praktike, të zhvilluara në 50 shkollat ku WorldVision në Shqipëri po zbaton Programin e Edukimit.

Një falënderim i veçantë shkon për fëmijët dhe të rinjtë e Qeverive të Nxënësve, Bordeve të Shkollave, mësuesve dhe drejtuesve të shkollave, mësuesve koordinatorë të Shkollës Qendër Komunitare në Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore. Me kontributin e tyre në plotësimin dhe përdorimin e portalit, hartimin e planeve të punës dhe zbatimin e tyre, me praktikat pozitive dhe sfidat e diskutuara në trajnimet dhe takimet e përbashkëta me IZHA-n dhe WV-in u hartua ky udhëzues, që do të shërbejë për çdo shkollë Qendër Komunitare në Shqipëri.

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	6
-------------------	----------

I. DY FJALË PËR SHQK-NË.....7

<i>1.1 Shkolla Qendër Komunitare.....</i>	<i>8</i>
<i>1.2 Pse ngrihen ShQK-të?.....</i>	<i>8</i>
<i>1.3 Fushat e veprimtarive të ShQK-së.....</i>	<i>8</i>
<i>Aktorët që përfshihen në shndërrimin e shkollave në qendra komunitare.....</i>	<i>9</i>

2. RËNDËSIA E PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE NË PROCESIN E VLERËSIMIT TË SHQK-SË..... 10

<i>2.1 Veprimtaritë të organizuara nga nxënësit në kuadër të Shkollës si Qendër Komunitare.....</i>	<i>12</i>
<i>2.2 Qeveria e nxënësve dhe nxënësit.....</i>	<i>14</i>
<i>2.3 Qeveria e nxënësve dhe drejtuesit e shkollës.....</i>	<i>14</i>
<i>2.4 Qeveria e nxënësve dhe Bordi i shkollës.....</i>	<i>14</i>
<i>2.5 Qeveria e nxënësve dhe komuniteti.....</i>	<i>15</i>
<i>2.6 Planifikimi i veprimtarive.....</i>	<i>15</i>
<i>2.7 Aftësitë që duhet të ketë lehtësuesi i procesit, që në shumicën e rasteve është dhemësuesi koordinator i ShQK-së ose drejtori dhe nëndrejtori i shkollës.....</i>	<i>16</i>

3. TËRHEQJA E TË GJITHË AKTORËVE PËR VLERËSIMIN DHE HARTIMIN E PLANIT TË SHQK-SË..... 17

<i>3.1 Çfarë është përfshirja e prindërve në shkollë.....</i>	<i>20</i>
<i>3.1.1 Prindërit si partnerë.....</i>	<i>21</i>
<i>3.1.2 Prindërit si partnerë dhe zgjidhës të problemeve të shkollës.....</i>	<i>21</i>
<i>3.1.3 Prindërit si vëzhgues.....</i>	<i>22</i>
<i>3.1.4 Prindërit si vullnetarë.....</i>	<i>22</i>
<i>3.1.5 Prindërit si këshillues dhe partnerë në vendimmarrje.....</i>	<i>22</i>
<i>3.1.6 Roli i këshillit të prindërve.....</i>	<i>22</i>
<i>3.1.6.1 Këshilli i prindërve të klasës.....</i>	<i>22</i>
<i>3.1.6.2 Përmirësimi i etikës së shkollës.....</i>	<i>23</i>
<i>3.1.7 Hapa për përmirësimin e kushteve në shkollë.....</i>	<i>24</i>
<i>3.1.8 Zëri dhe veprimi i shtetasit.....</i>	<i>25</i>
<i>3.1.9 Përmirësimi i shërbimeve dhe influencimi i politikave</i>	<i>26</i>

4. FUNKSIONIMI I PORTALIT TË shqk.edu.al.....28

Hyrje

Nëpërmjet kësaj guide synohet lehtësimi i procesit të vlerësimit të treguesve të standardeve të Shkollës Qendër Komunitare (ShQK), si dhe të jepen udhëzime për plotësimin e portalit nga aktorët që ndihmojnë në hartimin dhe zbatimin e planit të ShQK-së në shkollë.

Në mirëfunksionimin e këtyre shkollave, që punojnë për mirëfunksionimin e Shkollës Qendër Komunitare drejt arritjes së standardeve, shihet si një tregues shumë i rëndësishëm:

- ngritja e kapacitetit të strukturave të shkollës, si dhe
- bashkëpunimi ndërmjet aktorëve dhe partnerëve të Shkollës si Qendër Komunitare, mësuesve, prindërve, nxënësve, pushtetit vendor, bizneseve etj.

Metodologjia e vlerësimit të treguesve të SHQK-së, hartimi i një plani pune bazuar mbi analizën e hartës së burimeve, zbatimi i planit me elemente të monitorimit dhe përfshirja e komunitetit në vendimmarrje aktive në nivel bashkie bazohen në modelin e quajtur “Zëri dhe Vendimi i Qytetarit”. Ky model synon të sjellë së bashku grupe interesi, rreth një çështjeje të caktuar, për të vlerësuar se sa të zbatueshme janë standardet, dispozitat dhe ligjet, për të ngritur zërin për zbatimin e tyre, si dhe për të ndërmarrë veprime e angazhim komunitar për përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Gjatë realizimit të takimeve të periudhës dhjetor 2015 - shkurt 2016 me aktorët, është synuar që ata:

- të kenë arritur një kuptim të përbashkët të njëjtë mbi qasjen “Shkolla si Qendër Komunitare”;
- të dallojnë llojet e veprimtarive që zhvillon shkolla qendër komunitare kundrejt aktiviteteve që zhvillohen në kuadër të orëve ekstrakurikulare;
- të kenë zhvilluar aftësitë e duhura për të planifikuar në nivel institucioni, në afate kohore vjetore dhe tremujore, veprimtaritë në kuadrin e shkollës qendër komunitare bazuar në fushat dhe tregues specifikë të ShQK-së;
- të kenë zhvilluar aftësitë për të vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe mbështetjes nga aktorë të tjerë, si: komuniteti i prindërve, pushteti vendor, biznese lokale dhe më gjerë në zhvillimin e nismës: “Shkolla si Qendër Komunitare”.

Për t’i ardhur sa më shumë në ndihmë shkollës, është hartuar dhe portali: shqk.edu.al, i cili mundëson vlerësimin e standardeve të shkollës qendër komunitare dhe hartimin e planit të punës online. Së pari, në këtë udhëzues do të shpjegojmë se si realizohet procesi i vlerësimit dhe më pas hartimi i planit të punës. Në pjesën e dytë të guidës do të gjeni informacionin e nevojshëm se si plotësohet portali dhe si hidhen të dhënat që kërkohen prej tij.

Për çdo pyetje apo paqartësi që mund të keni gjatë realizimit të procesit, ju lutemi të drejtoheni në adresën e mëposhtme të e-mailit: infoshqk@gmail.com



I. Dy fjalë për ShQK-në

I.1 Shkolla Qendër Komunitare – parimet mbi të cilat ngrihet, veçoritë e saj, llojet e veprimtarive

Shkolla Qendër Komunitare (ShQK) është një model promovues dhe zhvillues për ta kthyer shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi.

Legjislacioni aktual për arsimin mbështet funksionimin e një shkolle të hapur për vendimmarrje të përbashkët me familjen dhe komunitetin.

Koncepti i shkollës qendër komunitare mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe paraqet një qasje gjithëpërfshirëse, që ndërlidh të gjitha aspektet e reformës në arsim.

ShQK-ja synon zhvillimin cilësor të shkollës dhe përgatitjen e fëmijëve dhe të rinjve si qytetarë të gatshëm dhe të aftë për të kontribuar në komunitetet e tyre.

Ky është një bashkëpunim mes aktorëve në komunitet, prindërve dhe shkollës, i fokusuar në:

- mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve;
- përmirësimin e arritjeve të tyre;
- mbështetjen e familjeve;
- zhvillimin e komuniteteve.

Veçori të ShQK-së

- ShQK bëhen ato institucione arsimore – qendra të komunitetit, të cilat janë të hapura për këdo dhe në çdo kohë. Ato janë të disponueshme për të gjithë anëtarët e komunitetit për shtatë ditët e javës.
- ShQK-të janë institucione të cilat e ngrenë dhe e zhvillojnë punën e tyre bazuar në nevojat e nxënësve, të familjeve dhe komunitetit të gjerë.
- Ofrojnë një sërë shërbimesh, pas orarit mësimor, në shtatë ditët e javës, për nxënësit, familjet dhe komunitetin.
- Mësuesit dhe nxënësit konsiderojnë prindërit si bashkëedukatorë dhe i angazhojnë ata në vendimmarrje të përbashkëta për çështje që lidhen me edukimin cilësor sipas fushave të standardeve të ShQK-së.
- Sigurojnë kohezionin social (forca që i mban të bashkuara fort të gjitha palët dhe shtresat brenda komunitetit).
- Ngrihen mbi pikat e forta të komunitetit duke u bazuar në hartëzimin e burimeve njerëzore, sociale, materiale, natyrore, shpirtërore dhe financiare që ekzistojnë në një komunitet.

Shkolla përdor rrugë të ndryshme për të bashkëpunuar me komunitetin. Këto mund të jenë veprimtari:

- për të sjellë shërbimet dhe programet e komunitetit në shkollë. Në këtë rast, shkolla vlerëson pjesët përbërëse të komunitetit, si organizata dhe institucione, qendra të shëndetit fizik e mendor, institucione të artit dhe kulturës, biznese etj.;
- që fokusohen në projekte të përbashkëta, të cilat ndihmojnë shkollën dhe shërbimin komunitar;
- për të plotësuar nevojat e fëmijëve, të rinjve dhe të komunitetit në lidhje me pesë fushat e ShQK-së.

I.2 Pse ngrihen ShQK-të?

Shumë njerëz i shohin sot shkollat si “ishuj të izoluar” nga komuniteti, madje dhe familjet. Ata i shohin shkollat si institucionet që i shërbejnë një qëllimi të vetëm: mësuesit japin mësim dhe nxënësit nxënë (mësojnë).

Shkolla, familja dhe komuniteti, sot përballen me një sfidë të përbashkët: edukimin më të mirë të mundshëm për fëmijët dhe të rinjtë, si dhe kërkojnë rrugë për t’iu përgjigjur nevojave të tyre përtej përgatitjes akademike. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të përballen me çështjet dhe problematikat sociale të komunitetit dhe, në të njëjtën kohë, partneriteti me prindërit dhe aktorët e tjerë krijon mundësinë e ngritjes dhe realizimit të projekteve të përbashkëta me tematika nga komuniteti, që lidhen specifikisht me treguesit e standardeve të ShQK-së, duke mundësuar gjetjen e rrugëve për zgjidhjen e problemeve dhe duke aftësuar nxënësit, prindërit dhe mësuesit për të kontribuar në komunitetet e tyre.

Në procesin e vlerësimit të standardeve të shkollës si qendër komunitare, familjet dhe komuniteti punojnë së bashku:

- për të ndërtuar strategji të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët, të rinjtë dhe familjet;
- për të pasuruar dhe nxitur të nxënin përmes veprimtarive formale dhe joformale;
- për të siguruar një mjedis që ofron dhe integron shërbime, të cilat aftësojnë për jetën, për shkollën familjen dhe komunitetin.

Studime të ndryshme, të kryera vitet e fundit, tregojnë se fëmijët dhe të rinjtë që kanë një perspektivë pozitive të mirëqenies së tyre, janë më të predispozuar për të bërë zgjedhje të shëndetshme në jetën e tyre, të cilat kontribuojnë direkt në të mësuarin e tyre gjatë gjithë jetës. Nxënësit nuk mund të kenë rezultate të larta mësimore nëse nuk ndihen të mirëpritur në shkollë, nuk aftësohen për jetën dhe nuk kanë një stil të jetuari të shëndetshëm, si në shkollë, ashtu dhe në komunitet.

I.3 Fushat e veprimtarive të ShQK-së

Veprimtari për zhvillimin akademik të nxënësve – Shkolla qendër komunitare ofron programe dhe shërbime që sigurojnë mbështetje dhe zhvillim akademik për nxënësit dhe të rinjtë, duke plotësuar programin mësimor dhe duke i ardhur në ndihmë veçanërisht fëmijëve dhe të rinjve me nevojë.

Ka disa rrugë për të mbështetur zhvillimin akademik të nxënësve:

- Veprimtari për përforsim të të nxënit. Këto veprimtari bëhen për të zotëruar më mirë aftësitë që nxënësi po zhvillon në klasën e tij, siç janë konsultimet lidhur me lëndët.
- Veprimtari për pasurimin e zhvillimit akademik. Këto kurse ngrihen mbi përmbajtjen e lëndës që nxënësi po zhvillon në klasën e tij dhe thellojnë të nxënit në një fushë të caktuar kurikulare apo dhe të fushave të tjera kurikulare, që nuk preken në atë klasë.


2. *Veprimtari kulturore sportive* – Shkolla qendër komunitare mundëson që programet dhe shërbimet që ajo ofron t’i adresohen nevojave të zhvillimit fizik, mendor, emocional dhe social të nxënësve. Nxënësit gjejnë në shkollë informacionin dhe mjetet për përmbushjen e këtyre nevojave. Shkolla ndërton programe të zhvillimit për mirëqenien dhe shëndetin (si, kurset, klasat, ekipet sportive për lojëra të ndryshme, si: volejball, basketboll, futboll, aerobi etj.) Këto veprimtari duhet të organizohen duke pasur në fokus ndërgjegjesimin dhe duke nxitur veprime konkrete për zhvillimin fizik, mendor, emocional dhe social të nxënësve.

Gjithashtu, shkolla shërben si urë lidhëse me strukturat e Mbrojtjes së Fëmijëve në zonë, shërbimin mjekësor, psiokologjik dhe shërbime të tjera të zonës, që kanë në fokus mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve.

3. Veprimtari për angazhimin dhe mbështetjen e familjes – Shkolla qendër komunitare i konsideron prindërit si partnerë dhe burime të rëndësishme. Ajo krijon një klimë pozitive, mirëseardhjeje dhe bashkëpunimi, si dhe ndërton programe për përfshirjen e prindërve në mënyrë të tillë që angazhimi komunitar për cilësinë në edukimin e fëmijëve dhe të rinjve të arrijë të jetë pjesa që mobilizon komunitetin e gjerë në shkollë e përtej mureve të saj.

4. Veprimtari për angazhimin e komunitetit – Shkolla qendër komunitare bashkëpunon ngushtë me komunitetin dhe mundëson programe, shërbime dhe mbështetje për anëtarët e komunitetit. Kjo shërben si burim për të nxënëit e komunitetit dhe shfrytëzimin e burimeve të komunitetit për zhvillimin e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve.

Aktorët që përfshihen në shndërrimin e shkollave në qendra komunitare:



Vizioni për zhvillimin e plotë të shndërrimit të shkollave në qendra komunitare

Shkolla qendër komunitare

Shndërrimi i shkollave në vendin ku realizohet partneriteti shkollë, familje dhe komunitet me fokus zhvillimin akademik, social, fizik dhe emocional të fëmijës, duke shfrytëzuar të gjitha burimet që ofron familja dhe komuniteti.

Sistemi / rrjeti i shkollave komunitare

Një rrjet i institucioneve arsimore, nga parashkollori e deri në klasën e 12-të, në një zonë të caktuar, i lidhur rreth një ose më shumë shkollave. Institucionet arsimore përdorin shkollën qendër komunitare për të gjetur shërbime.

Komunitete ku shkolla shihet si partner

Një komunitet që mbështet zhvillimin e të nxënëit të fëmijëve dhe të rinjve përmes bashkëpunimit të ngushtë me shkollat.

Fushat e ndërhyrjeve për kthimin e shkollës në ShQK:

- Ndërgjegjësim i të gjithë aktorëve mbi qasjen e shkollës si qendër komunitare, përmes bisedave, tryezave, debateve të hapura, botimeve etj.
- Përmirësimi i infrastrukturës shkollore për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të larmishme.
- Vënia në dispozicion të shkollave e materialeve të domosdoshme për të prekur fusha të ndryshme të tematikave passhkollore.
- Ngritja e kapaciteteve të drejtuesve të shkollave, mësuesve, prindërve dhe përfaqësuesve në komunitet për bashkëpunim të efektshëm në veprimtarinë e shkollës.
- Fuqizimi i strukturave të shkollës, ku kanë rol aktiv prindërit dhe komuniteti. Bordi i shkollës, qeveria e nxënësve, këshilli i prindërve dhe komisione të ndryshme në shkollë, si: komisioni i shëndetit, i sigurisë së shkollës, komisioni i etikës, komisioni i vlerësimit etj.
- Hartimi dhe zbatimi i programeve që mbështesin shkollat në eliminimin e fenomeneve si braktisja shkollore, dhuna në shkollë; zgjidhja e konflikteve, të drejtat e njeriut etj.
- Shkëmbimi i përvojave pozitive me institucione shkollore brenda dhe përtej vendit tonë.

Standardet e ShQK-së

- **Standardet e ShQK-së** janë një përmbledhje e karakteristikave më themelore që duhet të ketë një shkollë për të përmbushur misionin e saj komunitar.
- Ato janë të shprehura nëpërmjet pesë fushave dhe për secilën fushë jepen **treguesit përkatës, të cilët janë të matshëm.**

Fushat e standardeve

- **Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënës**
- **Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve**
- **Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit**
- **Vendimmarrja e përbashkët**
- **Gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit**

2. Rëndësia e përfshirjes së nxënësve në procesin e vlerësimit të ShQK-së

Në këtë kapitull do të trajtohet tema për rëndësinë e përfshirjes në këtë proces, cili është roli i lehtësuesit gjatë bashkëpunimit të prindërve-mësuesve-nxënësve dhe komunitetit. Çfarë duhet të kemi parasysh, që gjatë procesit të dëgjohet zëri i fëmijëve?

Në kuadër të Shkollës Qendër Komunitare, shpeshherë propozohet që drejtori ose nëndrejtori i shkollës të jetë koordinator qendror i Shkollës Qendër Komunitare.

Koordinatori kryesor i Shkollës Qendër Komunitare ka si funksion kryesor lehtësimin e procesit për funksionimin e ShQK-së. Në këtë nismë koordinatori kryesor ndihmon në angazhimin dhe bashkëpunimin me prindërit, komunitetin, biznesin, shoqatat dhe aktorë të tjerë që ndihmojnë në menaxhimin dhe mbarëvajtjen e shkollës.

Mësuesit koordinatorë ndihmojnë në vlerësimin e standardeve të ShQK-së, duke marrë në konsideratë mendimet dhe pikëzimin e nxënësve, prindërve dhe anëtarëve të bordit. Pas realizimit të vlerësimit të standardeve, këta aktorë hartojnë bashkërisht planin e punës së ShQK-së. **Realizimin e këtij procesi e gjeni të shpjeguar në kapitullin në vijim.**

Shkolla Qendër Komunitare e ka nismën nga Konventa e Drejtave të Fëmijëve dhe, si e tillë, përfshirja e tyre në këtë nismë është parësore. Fëmijët dhe të rinjtë janë pjesë aktive gjatë procesit të vlerësimit të standardeve të Shkollës Qendër Komunitare, ata janë kontribues aktivë në mirëqenien dhe zhvillimin e tyre. Fëmijët kanë përvojat e tyre, jetojnë në kontekstet shkollore, ata duhet të shihen si agjentë ndryshimi, të cilët analizojnë dhe marrin nisma që sigurojnë një shkollë miqësore.

Në mjediset shkollore ka raste që fëmijët dhe të rinjtë ndihen të lënë pasdore dhe iu krijohet ideja që mendimet e tyre nuk merren parasysh, prandaj është e rëndësishme që ata të jenë pjesë e procesit dhe të jenë të motivuar për të realizuar veprimtaritë e Shkollës Qendër Komunitare..

Kjo mënyrë bashkëpunimi nxit pozitivisht shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve. Nëse fëmijët dhe të rinjtë bashkëbisedojnë me komunitetin dhe mësuesit, rezultatet e programit do të jenë më efektive duke rritur përgjegjësinë qytetare të fëmijët dhe të rinjtë.

Organizmat përfaqësues të nxënësve në shkollë luajnë rol parësor në edukimin e vlerave dhe qëndrimeve demokratike, dhe i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë dhe të binden se edhe ata mund të jenë aktorë të ndryshimit, në shkollë, në komunitet dhe më gjerë në shoqëri.

Objekti i punës së Qeverisë së nxënësve përbëhet nga veprimtari të cilat përmbushin rolin e saj. Qeveria e nxënësve mund të hartojë dhe të zbatojë, në marrëveshje me drejtuesit e shkollës, projekte që janë në interes të përmbushjes së objektivave të shkollës dhe të rritjes së mirëqenies së nxënësve të saj.

Qeveria e nxënësve, megjithëse përbëhet nga një grup nxënësish, në të vërtetë është zëdhënëse e interesave të komunitetit të nxënësve për të mbrojtur të drejtat e tyre, për të kontribuar në plotësimin e nevojave dhe zhvillimin e interesave të tyre, duke synuar një shërbim arsimor sa më cilësor. Njëpërmjet qeverisë së tyre, qeverisin të gjithë nxënësit e shkollës. Ata përfshihen në zgjidhjen e problemeve të shkollës, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, stafin dhe prindërit, në të mirë të shkollës dhe të vetë nxënësve.

Funksionimi i Qeverisë së nxënësve krijon një mentalitet të ri për pozicionin dhe rolin e nxënësve në shkollë, duke i parë ata si partnerë dhe pjesëmarrës aktivë në proceset e vendimmarrjes në shkollë dhe në zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Qeveria e nxënësve bashkëvepron me organet kolegjiale të shkollës.

Qeveria e nxënësve planifikon dhe realizon një gamë të gjerë veprimtarish, ndër të cilat veprimtaritë që do të përmenden më poshtë.



2.1 Veprimtaritë të organizuara nga nxënësit në kuadër të Shkollës si Qendër Komunitare

Veprimtari për vlerësimin e nevojave të komunitetit të nxënësve

Veprimtari të tilla kanë të bëjnë me përfaqësimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve të nxënësve te drejtuesit e shkollës ose organet kolegjiale. Këtu përfshihen si veprimtari që kanë të bëjnë me mbledhjen e informacionit nga nxënësit (me anë të bisedave, vëzhgimeve, pyetësorëve etj.), ashtu edhe veprimtari që kanë të bëjnë me paraqitjen e informacionit te drejtuesit e shkollës ose organet kolegjiale dhe diskutimin me ta. Në udhëzuesin e ShQK-së janë dhënë pyetësorë konkretë që ne mund të organizojmë me nxënësit për të marrë në konsideratë nevojat e tyre. Është e rëndësishme që të nxisim nxënësit të jenë pjesëmarrës dhe aktivë gjatë plotësimit të pyetësorëve, duke i bindur që ata janë anonimë dhe, mundësisht, të lihen kuti në fund të klasës, në mënyrë që ata të mund t'i hedhin këta pyetësorë. Vetëm duke marrë në konsideratë analizën e pyetësorëve, ne mund të hartojmë aktivitete që iu përgjigjen nevojave të komunitetit dhe të nxënësve.



Veprimtari që nxisin një komunikim më të mirë brenda në shkollë

Përmirësimi i komunikimit brenda komunitetit të shkollës është një përgjegjësi e përbashkët dhe Qeveria e nxënësve mund të kontribuojë në këtë proces duke ndërtuar ura komunikimi me nxënësit e shkollës, drejtuesit e shkollës, stafin dhe prindërit. Këtu përfshihen prezantimi para mësuesve dhe këshillit të prindërve i veprimtarive të kryera, nxjerrja e një gazete etj. Qeveria e nxënësve bashkëpunon me Bordin e shkollës në ato raste kur tematika përfshihet në funksionet e Bordit. Bordi i shkollës jo vetëm dëgjon përfaqësuesit e Qeverisë së nxënësve, por edhe iu përgjigjet konkretisht shqetësimeve të saj. Mbështetja dhe udhëzimet e ofruara nga një mësues janë shumë të dobishme për një Qeveri nxënësish, kur planifikon apo organizon veprimtaritë (për shembull, për organizimin e një veprimtarie sportive mund t'i kërkohet mendim mësuesit të edukimit fizik). Nga ana tjetër është e dëshirueshme të ftohen në mbledhje të personelit mësimor anëtarë të Qeverisë së nxënësve, në rastet kur tematika përshtatet me funksionet ose me veprimtarinë aktuale të Qeverisë së nxënësve.

Veprimtari për të ndihmuar nxënësit e tjerë për përparimin e tyre

Qeveria e nxënësve mund të kontribuojë duke propozuar metoda konkrete në funksion të përparimit të nxënësve. Për shembull, për të ndihmuar nxënësit me vështirësi në të nxënë, për të ndihmuar integrimin e nxënësve që fillojnë për herë të parë shkollën ose një nivel shkollimi (për shembull, klasën e 10-të në rastin e gjimnazeve, parashkollorin ose klasën e parë për ciklin fillor) etj.

Veprimtari që ndihmojnë mbarëvajtjen e shkollës

Qeveria e nxënësve mund të japë ndihmesë në mënyrë aktive në mbarëvajtjen e shkollës, duke formuar grupe të përkohshme pune me nxënës për një çështje të posaçme (për shembull, për disiplinën, për mjedisin etj.) dhe të paraqesë te drejtuesit propozime konkrete. Qeveria e nxënësve mund të propozojë edhe veprimtari jashtëkurikulare (për shembull, organizimin e konkurseve).

Veprimtari që lidhen me ngjarje shkollore sportive dhe kulturore

Qeveria e nxënësve mund të ndihmojë në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe kulturore në shkollë. Në shkollë mund të kemi nxënës të talentuar në sporte të caktuara dhe, pse jo, ata mund të shërbejnë si nxënës orientues për organizimin e aktiviteteve të tilla. Madje, mund ta shpërndajnë këtë eksperiencë edhe te më të vegjlit. Duhet të marrim në konsideratë që nxënësit i dëgjojnë më me dëshirë shokët e tyre dhe janë më të gatshëm për të ndihmuar në organizimin e aktiviteteve.

Veprimtari që sigurojnë komunikimin me Qeveritë e nxënësve të shkollave të tjera

Krijimi i një rrjeti të shkollave si qendra komunitare dhe shkëmbimi i përvojave midis tyre kërkon dhe mundëson që Qeveria e nxënësve të një shkolle të bashkëpunojë me Qeveritë e nxënësve të shkollave të tjera (për shembull, për veprimtari të përbashkëta artistike, sportive, projekte të përbashkëta etj.). Në këtë këndvështrim, një vlerë të veçantë do të kishte bashkëpunimi me një qeveri nxënësish të formuar rishtazi në favor të kësaj të fundit.

Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive mes shkollës dhe partnerëve të shkollës kërkon komunikim dhe bashkëpunim të nxënësve dhe të të gjitha palëve të përfshira, si brenda në shkollë, ashtu dhe jashtë saj.

2.2 Qeveria e nxënësve dhe nxënësit

Qeveria e nxënësve është element i rëndësishëm i planifikimit dhe i vendimmarrjes në shkollë. Ajo është lidhja kryesore midis familjes, komunitetit dhe shkollës. Rolet e saj janë të qarta:

- Është partnere ose lehtësuese në punën për arritjen e objektivave të shkollës.
- Qeveria e nxënësve përcjell zërin e nxënësve në strukturat e tjera të shkollës dhe, nëse është e nevojshme, edhe jashtë saj për plotësimin e interesave të komunitetit të nxënësve, për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe për një arsimim sa më cilësor.
- Inkurajon dhe lehtëson angazhimin e prindërve dhe të komunitetit në procesin e planifikimit dhe zhvillimeve në shkollë.

Komunikimi ndërmjet Qeverisë së nxënësve dhe nxënësve të shkollës, ndërmjet Qeverisë së nxënësve dhe drejtuesve të shkollës, mësuesve e prindërve është shumë i rëndësishëm dhe synon që i gjithë komuniteti i shkollës të kuptojë dhe të ndihmojë në realizimin e programeve dhe veprimtarive që nxënësit planifikojnë.

Nxënësit duhet të informohen rregullisht për veprimtaritë e Qeverisë së nxënësve. Përfaqësues të çdo klase duhet të informojnë dhe të dëgjojnë rregullisht opinionet dhe idetë e nxënësve të klasës.

Atyre duhet t'u krijohet mundësia të shprehin pikëpamjet e tyre për çështjet që diskutohen në Qeverinë e nxënësve dhe për të propozuar çështje për diskutim.

Një komunikim i frytshëm dypalësh realizohet konkretisht me forma e mjete të ndryshme, disa prej të cilave rekomandohen në vijim:

- Afishimi i planit të veprimtarive dhe i veprimtarive të zhvilluara nga nxënësit në kuadër të këtij programi. Këtij qëllimi mund t'i shërbejë përgatitja e një gazete ose reviste, si një mënyrë e dobishme informimi, e cila ndërgjegjëson për arritjet, për planet në vazhdim dhe rrit interesin dhe pozitivitetin për punën e Qeverisë së nxënësve.
- Takime periodike të nxënësve përfaqësues në organizmat e shkollës me nxënës të klasave të tyre për qëllime informimi dhe marrjen e mendimeve e sugjerimeve në lidhje me veprimtaritë e planifikuara.
- Këshillime me drejtuesit e shkollës, Bordin, mësuesit e Këshillin e prindërve për probleme që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e shkollës.
- Një nga mënyrat me të cilën nxënësit e shkollës komunikojnë me qeverinë e tyre është ajo informale, nëpërmjet bisedave të lira.

Kryesia e Qeverisë së nxënësve duhet të planifikojë edhe mënyra të tjera formale për t'u informuar për interesat, dëshirat, problemet dhe sugjerimet e nxënësve të shkollës, si për shembull:

- të caktojë një orar në mjedisin e saj të punës për takime me nxënësit;
- të zhvillojë biseda të organizuara me nxënës të një klase, edhe thjesht për të informuar për punën kryer;
- të zhvillojë pyetësorë apo intervista për një temë të caktuar;
- të qarkullojë planin mujor të veprimtarive për të marrë reagime nga nxënësit;
- të vendosë diku në shkollë një kuti, ku nxënësit mund të fusin ide dhe sugjerime.

2.3 Qeveria e nxënësve dhe drejtuesit e shkollës

Drejtuesit e shkollës, jo vetëm për funksionin e tyre si përgjegjës të ekipit koordinator të shkollës si qendër komunitare, por dhe për rolet që përmbushin në këtë proces, kanë një detyrim në krijimin e një hapësire të sigurt ku fëmijët mund të flasin dhe shprehin lirisht mendimet e idete e tyre. Drejtuesit e shkollave duhet të jenë nismëtarë dhe mbështetës të pjesëmarrjes së nxënësve në veprimtari që nxisin përmirësimin e cilësisë së të nxënësve, që sigurojnë përmbushjen e interesave dhe nevojave të nxënësve, si dhe mundësojnë pjesëmarrjen e komunitetit.

Roli i drejtorit të shkollës është i dyfishtë: nga njëra anë si bashkëpunues dhe udhëzues i vazhdueshëm i nxënësve për planifikimin dhe zhvillimin e veprimtarive dhe nga ana tjetër si monitorues i tyre.

Nga njëra anë, drejtuesi duhet të jetë i gatshëm të këshillohet me Qeverinë e nxënësve; të dëgjojë, të reflektojë dhe të përfshijë Qeverinë e nxënësve në çështje të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien e nxënësve.

Nga ana tjetër, Qeveria e nxënësve për një sërë problemesh duhet të ndiejë nevojën për këshillim me drejtuesin.

2.4 Qeveria e nxënësve dhe Bordin i shkollës

Në Bordin e shkollës bëjnë pjesë një ose më shumë përfaqësues të Qeverisë së nxënësve, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin përkatës. Kryetari i Qeverisë së nxënësve merr pjesë edhe në disa prej komisioneve të formuara nga Bordin i shkollës.

Disa ndër format e bashkëpunimit mund të jenë:

- Anëtarë të Bordit të shkollës mund të ftohen herë pas here të marrin pjesë në mbledhjet e Qeverisë së nxënësve.
- Kryetari i Qeverisë së nxënësve ose përfaqësues të saj prezantojnë herë pas here para Bordit punën e kryer. Për projekte të cilat ndërmerren në bazë shkolle, Qeveria e nxënësve bashkëpunon me Bordin.

2.5 Qeveria e nxënësve dhe komuniteti

Qeveria e nxënësve mund të jetë një burim i rëndësishëm dhe i besueshëm informacioni rreth komunitetit, duke ndërtuar së pari “Profilin e shkollës komunitare”. Ky lloj profili përfshin një përshkrim të kushteve ekonomike, shoqërore dhe shëndetësore të komunitetit të shkollës dhe përfshin identifikimin e nevojave të komunitetit, që lidhen me të nxënit e nxënësve dhe mirëqenien e tyre. Qeveria e nxënësve mund të nisë krijimin e këtij profili, së pari duke identifikuar fushat e përgjithshme, të cilat përfshijnë:

- *Kushtet ekonomike, shoqërore dhe shëndetësore të komunitetit*
- Familjarizimi me kushtet ekonomike, shoqërore dhe shëndetësore të komunitetit mund të shërbejë për të kuptuar mjedisin e gjerë në të cilin nxënësit mësojnë dhe jetojnë.
- *Nevojat dhe dëshirat e anëtarëve të komunitetit*
- Identifikimi i nevojave dhe i dëshirave të komunitetit i shërben Qeverisë së nxënësve të njohë më mirë barrierat që kushtëzojnë suksesin e nxënësve.
- *Burimet*
- Identifikimi i burimeve të komunitetit e ndihmon Qeverinë e nxënësve për krijimin e një pamje të përgjithshme të mundësive që mbështesin suksesin e nxënësve dhe mirëqenien e tyre.

Për secilën nga fushat, Qeveria e nxënësve mund t’i adresojë vetes pyetjet:

- Cili është informacioni që mund të na nevojitet?
- Cilat mund të jenë burimet e informacionit në komunitet?
- Cila mund të jetë rruga më e mirë për ta grumbulluar informacionin?

Burimet e komunitetit mund të klasifikohen dhe analizohen si më poshtë:

- Burime njerëzore: vullnetarë, ekspertize teknike;
- Burime sociale: inkurajim i drejtuesve, persona me influencë në zonë, rrjete sociale;
- Burime natyrore: tokë e përbashkët, ujë etj.;
- Burime financiare: grante, donacione, bursa;
- Burime shpirtërore: udhëheqje shpirtërore, vlera në komunitet;
- Burime materiale: salla, ambiente për takime, materiale të ndryshme të dhuruara.

2.6 Planifikimi i veprimtarive

Është shumë e rëndësishme që, kur hartohet plani i shkollës si qendër komunitare, t’i kushtohet rëndësi të veçantë gjetjes së strategjive të përshtatshme për të tërhequr sa më shumë aktorë në komunitet, për zbatimin e planit dhe realizimin e veprimtarive të parashikuara në të. Shumë nga aktorët nuk tërhiqen për të marrë pjesë në veprimtaritë e parashikuara, nëse nuk janë prezent aq sa duhet në planin e hartuar dhe nëse nuk shohin në të mjaftueshëm atë që do të “korri” nga kjo pjesëmarrje dhe përfshirje e tyre.

Qeveria e nxënësve harton planin e saj vjetor, ku planifikohen veprimtaritë për të gjithë vitin. Është e dobishme që për hartimin e planit vjetor të merret mendimi i sa më shumë nxënësve.

Plani vjetor duhet të jetë realist, domethënë të parashikojë veprimtari që mund të kryhen. Çdo veprimtari, që të rezultojë e suksesshme, duhet menduar e planifikuar me kujdes dhe me detaje.

Plani vjetor hartohet mbi bazën e prioriteteve të identifikuara nga secila klasë e shkollës nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Hartimi i planit vjetor duhet t'i referohet edhe planit vjetor të shkollës për të evituar paralelizmat dhe kundërshtitë. Për këtë arsye organizohen takime konsultative me Drejtorin e shkollës dhe me Bordin e shkollës. Varianti përfundimtar, pas prezantimit në secilën klasë, shpallet që të bëhet i njohur për të gjithë dhe një kopje i dërgohet Drejtorit të shkollës.

Gjatë zbatimit të planit vjetor, vendimi për ndonjë ndryshim merret me shumicë votash në një mbledhje të Bordit të shkollës.

Plani vjetor detajohet në plane mujore.

Pas mbarimit të një veprimtarie, është në dobi të punës të gjendet koha për ta vlerësuar:

- Nëse ishte e suksesshme? Nëse po, çfarë funksionoi?
- Çfarë problemesh pati?
- Çfarë duhet pasur parasysh për herën tjetër?

Në fund të vitit vlerësohet e gjithë puna: “Çfarë është arritur, çfarë nuk është arritur dhe pse?”. Për këtë qëllim hartohet raporti përfundimtar, i cili merr parasysh edhe opinionet me shkrim nga Drejtori, Bordi i shkollës dhe Këshilli i prindërve. Të gjithë nxënësve të shkollës u jepet mundësia të lexojnë raportin përfundimtar dhe të japin rekomandime dhe mendime në rastet kur është e nevojshme.

Qeveria e nxënësve mund të hartojë e të zbatojë projekte dhe veprimtari, të cilat:

- janë në interes të procesit mësimor;
- ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në proceset e vendimmarrjes;
- edukojnë vlera dhe qëndrime demokratike;
- ndikojnë në ndërgjegjësimin e nxënësve për problemet sociale brenda dhe jashtë shkollës;
- aftësojnë nxënësit për zgjidhjen e problemeve me të cilat ndeshet moshë e tyre;
- përmirësojnë kushtet e shkollës;
- ndikojnë në ruajtjen e mjedisit;
- ndikojnë pozitivisht në klimën e shkollës.

Për të nxitur marrjen e mendimeve të nxënësve dhe për të krijuar besim tek ata, roli i lehtësuesit është primar. Për të realizuar me sukses këto veprimtari, është e rëndësishme që lehtësuesi të ketë një kontribut të gjerë gjatë takimeve me fëmijët.

2.7 Aftësitë që duhet të ketë lehtësuesi i procesit, që në shumicën e rasteve është dhe mësuesi koordinator i ShQK-së ose drejtori dhe nëndrejtori i shkollës:

- të kuptojë fëmijët,
- të kuptojë prindërit,
- të jetë krijues,
- të hulumtojë me kujdes,
- të lehtësojë diskutimin,
- të nxisë/motivojë pjesëmarrjen e të gjithëve,
- t'u krijojë hapësira pjesëmarrësve, veçanërisht fëmijëve,
- të jetë elastik gjatë procesit të lehtësimit,

- të kuptojë pushtetet dhe diferencat gjatë takimit, duke siguruar balanca të drejta mes pjesëmarrësve

Në një proces ku përfshihen aktorë të ndryshëm dhe nxënës duhet të kihet parasysh disa parime themelore për lehtësuesin:

- Është e rëndësishme të jetë i mirinformuar paraprakisht për përmbajtjen e temës që do të trajtohet dhe formën e realizimit të procesit.
- Duhet të jetë i vëmendshëm ndaj sugjerimeve që vijnë nga pjesëmarrësit dhe të tregojë barazi ndaj gjithsecilit.
- Të tregojë respekt për hapësirën e tyre private, të ketë një gjuhë komunikimi të qetë, të dëgjojë me vëmendje gjithsecilin, të krijojë hapësira ku pjesëmarrësit të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në proces.
- Të përdorë gjuhë të thjeshtë dhe jo teknike, të përshtatet me kontekstin ku zhvillohet takimi.
- Të respektojë diversitetin.
- Gjatë diskutimit të merret me idenë dhe jo me personin që e ka dhënë atë.
- Të krijojë mundësi që të pranishmit të mund të bëjnë pyetje.
- Duhet të jetë miqësor me të pranishmit e me fëmijët dhe t'i ndihmojë ata për të shfaqur mendimet e tyre.

3. Tërheqja e të gjithë aktorëve për vlerësimin dhe hartimin e planit të ShQK-së

Ashtu siç e shpjeguar në kapitullin e dytë, gjatë realizimit të planit të ShQK-së është shumë e rëndësishme që të gjithë aktorët të jenë prezentë në vlerësimin e standardeve të ShQK-së dhe, më pas, në hartimin e planit të punës, që do t'i përgjigjej më mirë arritjes së disa prej treguesve të standardeve të ShQK-së.

Realizimi i procesit të vlerësimit të standardeve

Qasja e sugjeruar është që treguesit të vlerësohen fillimisht nga të tria grupet veçmas. Brenda një dite mund të ndodhë procesi i vlerësimit, ku fëmijët, prindërit dhe **l'mësuesit** vlerësojnë treguesit në grupe të veçanta. Ky proces është shumë i rëndësishëm për faktin që krijon hapësirë e duhur që fëmijët me ndihmën e lehtësuesit të vlerësojnë të gjithë treguesit sipas mendimit të tyre, e njëjta gjë për prindërit dhe më pas për mësuesit.

Pas kësaj pjese të procesit, roli i mësuesit koordinator si lehtësues i takimit është shumë i rëndësishëm për të sjellë bashkë përfaqësi nga tri grupet, ku të diskutohet pikëzimi i përbashkët.

Një nga metodologjitë e sugjeruara për vlerësimin në grup është që të gjithë pjesëmarrësit që janë në grupe të caktuara, **në të njëjtën kohë**, vlerësojnë në shkallën 1-10, vlerën që ata mendojnë se përfaqëson realitetin në shkollën e tyre.

Kjo metodologji i jep çdo pjesëtar të një grupi më shumë mundësi për të shprehur mendimin e vet pa u influencuar nga të tjerët. Më pas diskutohen pikët dhe bihet dakord me grupin.

Ndërkohë, për vlerësimin në një grup të madh (me përfaqësinë nga të tria grupet), dy nga metodat e testuara në shkollat ku World Vision ka zbatuar këtë lloj qasjeje, kanë qenë si vijon:

¹ Gjatë procesit të vlerësimit, te grupi i mësuesve është mirë të ftojme specialistë apo aktorë që kanë potencial në përmirësimin e standardeve të ShQK-së, si: punonjës socialë, psikologë, organizata e biznese të ndryshme që operojnë në zonë, specialistë nga njësi administrative apo Bashkia, si dhe përfaqësues nga DAR/ZA.

Skenari 1

Mësuesi koordinator përmbledh vlerësimin e tria grupeve për secilin nga treguesit, në mënyrë transparente, dhe më pas nxjerr mesataren, duke i vendosur treguesit në fjalë mesataren e pikëve të të tria grupeve.

Skenari 2

Skenari i dytë që ka funksionuar në lidhje me rënien dakord të grupeve, ka qenë metodologjia ku të tria grupet me anë të përfaqësueve negociojnë mes tyre nën lehtësimin e koordinatorit shkollor për çdo tregues. Kjo ka rezultuar si qasja më e gjatë, por më efektive, pasi diskutimi i gjeneruar mes grupeve ndihmon për të arritur të kuptuarin akoma më të mirë të standardeve dhe përmbajtjes së tyre.

E rëndësishme është që para çdo vlerësimi, mësuesi koordinator të shpjegojë kuptimin e fushave, standardeve dhe treguesve. Ky proces është mjaft i rëndësishëm për faktin që personat e përfshirë në vlerësim do të jenë në gjendje të zhvillojnë një proces më të qëllimshëm analize të situatës së shkollës. Procesi që shkolla kalon duke u ndalur te çdo tregues, nga eksperiencia e vitit të kaluar, ka treguar që shkollat që kanë ndjekur këtë lloj procesi edhe planet e ShQK-së i kanë më strategjike dhe të bazuara realisht mbi treguesit që duhen përmirësuar. Për hartimin e planit ndiqet modeli i sugjeruar në Portal. Në punën e grupit diskutohen fillimisht:

1. veprimtaritë, pra aktivitetet që shkolla ka vendosur të ndërmarrë për të përmirësuar treguesit e vet; qëllimi ku kontribuojnë veprimtaritë që do të ndërmerren;
2. afatet kur parashikohet të zhvillohen aktivitetet, në mënyrë që ndërhyrja të jetë sa më objektive; dhe vendosen bashkërisht se kush do të jenë personat që do të përbëjnë grupin përgjegjës për zbatimin e veprimtarive;
3. kontributet dhe përkushtimi i palëve të ndryshme, pasi analizohet harta e burimeve, siç u përshkrua më sipër;
4. cilësohet fusha që shkolla ka vendosur të përmirësojë;
5. plotësohen më pas të dhënat e tjera, si: shkolla, qyteti dhe komente të ndryshme që shkolla mund të dojë të theksojë dhe të dokumentojë.



Për të realizuar këtë proces, Drejtori i shkollës, Kryetari i Bordit dhe Presidenti i Qeverisë së nxënësve ndihmojnë koordinatoren e ShQK-së për të realizuar një takim me të gjithë specialistët apo aktorët që kanë potencial dhe përgjegjësi në përmirësimin e standardeve të ShQK-së, duke mbështetur shkollën në zgjidhjen e nevojave të saj. Idealja do të ishte të vendosej një orar dhe një ditë e përshtatshme për prindërit, nxënësit, anëtarët e komunitetit, përfaqësuesit e biznesit dhe organizatave të ndryshme që operojnë në zonë, specialistët nga njësia administrative apo Bashkia, si dhe për përfaqësuesit nga DAR/ZA. Aktorët e sipërpërmendur janë pjesë e procesit që në fillim. Në mënyrë që këta aktorë të jenë të familjarizuar për të realizuar vlerësimin e standardeve, do të ishte mirë që secilit prej tyre t'u dërgoheshin paraprakisht standardet e ShQK-së.

Për të printuar instrumentin e vlerësimit të ShQK-së, mjafton të shkoni te faqja:
shqk.edu.al².

Roli i koordinatorit shkollor si lehtësues i procesit të vlerësimit të shkollës dhe në hartimin e planit të ShQK-së

Koordinatori shkollor lehtëson procesin e pikëzimit, duke dhënë argumente për secilën palë, në mënyrë që të ndihmojë të kuptuarin dhe pranimin e realizimit apo mosrealizimit të një objekti, veprimtarie apo nisme mes palëve. E rëndësishme është që të ketë dëgjim aktiv dhe individët të ndihen të lirshëm për të shprehur mendimin e tyre. ***Mbi të gjitha, nxënësit duhet të ndihen sa më komodë në këtë proces, madje mund të propozohet që gjatë këtij procesi të jetë i pranishëm një prind ose psikologu i shkollës, për të ndihmuar nxënësit që të jenë pjesë e diskutimit.*** Është shumë e rëndësishme që secili nga pjesëmarrësit të shprehë mendimin e tij. Pas këtij procesi, mësuesi koordinator i ShQK-së hedh në portal vlerësimin përfundimtar të standardeve, që doli nga vlerësimet e të tria grupeve.

Ata që hartojnë planin mund të përballen me pyetjen: “Si do t'i tërheqim dhe do t'i bëjmë pjesë të planit aktorët që duam të përfitojnë nga veprimtaritë e ofruara?”. Për ta zgjidhur këtë çështje duhet që:

- veprimtaritë që ofrohen në plan të jenë me interes për të gjithë aktorët dhe të përfshijnë në hartim dhe zbatim struktura që kanë për detyrë t'u përgjigjen standardeve të ShQK-së;
- programi t'u përgjigjet interesave individuale të çdo aktori, si për shembull: marrëdhënie pozitive mësues - fëmijë dhe mes vetë fëmijëve, dëshirë për të ndihmuar të tjerët dhe për të ndërgjegjësuar për potencialin që çdo fëmijë ka, nevojë për zhvillim fizik, emocional, social të fëmijëve etj.;
- të ketë pjesëmarrje dhe përfshirje të vazhdueshme të aktorëve në veprimtaritë e planifikuara, sidomos ato që kanë një natyrë angazhimi komunitar, dhe iniciativa advokuese në shkolla;
- të mbështeten fëmijët dhe të rinjtë për përfshirjen në veprimtaritë e planifikuara nga të rriturit në komunitet, si dhe bizneset e zonave.

Në disa raste ka edhe pengesa që ndikojnë në tërheqjen dhe përfshirjen e sa më shumë aktorëve për zbatimin e planit të hartuar. Më poshtë janë renditur disa nga pengesat e mundshme:

- mungesa e një vizioni të qartë;
- prioriteti i dy ose tri fushave përnjëherësh;
- iniciativa që nuk lidhen drejtpërdrejt me standardet, si: aktivitete kulturore ose sportive apo festimi i ditëve si 7 Marsi, festat e fundvitit etj., që nuk janë aktiveve në kuadër të ShQK-së;

² Procedurën për printimin e instrumentit e gjeni të shpjeguar në kapitullin 4.

- role dhe përgjegjësi të paqarta për stafin mësimor dhe aktorët e tjerë përfaqësues të komunitetit që do të përfshihen, si për shembull: mësues që vendosen për zbatimin e planit pa qenë të konsultuar paraprakisht;
- pritshmëri jo të përshtatshme për stafin mësimor dhe pjesëtarët e tjerë të përfshirë në program;
- mosqëndrueshmëria e veprimtarive të planifikuara dhe mosvendosja e afateve kohore;
- moszbatimi i planit ashtu siç është parashikuar në veprimtari dhe i afateve, si dhe mungesa e një plani monitorimi nga vetë anëtarët e shkollës;
- mungesa e trajnimit për stafin e shkollës dhe aktorët e tjerë ose trajnim jo i përshtatshëm për ta, që lidhet me komponentin e mobilizimit komunitar, si qasja kryesore e ShQK-së;
- mungesa e komunikimit ose e koordinimit mes strukturave të shkollës dhe drejtuesve të shkollës;
- mungesa e përfshirjes që në momentin e hartimit të planit çon që individët e përfshirë në një fazë të dytë nuk e kuptojnë apo nuk janë të qartë sa duhet në lidhje me qëllimin e planit dhe dobitë e tij;
- organizimi i festave të shkollës, i panireve ose i aktiviteteve sportive nuk janë plane për të adresuar fushat dhe standardet e ShQK-së. Të gjitha këto aktivitete mund të përfshihen në planet e shkollave, nëse kanë të theksuar një qëllim që lidhet dhe adreson fushën dhe standardet përkatëse.

Është shumë e rëndësishme që para se të realizojmë vlerësimin e ShQK-së dhe të hartojmë planin e saj, të marrim parasysh kriteret e sipërpërmendura.

3.1 Përfshirja e prindërve në vlerësimin e shkollës si qendër komunitare

Në kuptimin e gjerë të fjalës, përfshirja e prindërve në edukim ka për qëllim që t'i ndihmojë ata të kuptojnë më mirë se çfarë është:

- prindërimi (të qenët prind) - shprehitë që përdorin prindërit për të rritur dhe edukuar fëmijët e tyre;
- edukimi i prindërve - informacioni rreth çështjeve që mund të ndikojnë në jetën e fëmijëve të tyre;
- përfshirja e prindërve në procesin mësimor - rrugët e ndryshme për të mbështetur fëmijët e tyre në shkollë, si dhe për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes lidhur me procesin mësimor dhe të funksionimit të shkollës.



Përfshirja e prindërve në edukim është një koncept i gjerë, sepse shfaqet në shumë forma dhe realizohet në shumë mënyra. Mjaft materiale teorike përshkruajnë role të ndryshme që prindërit mund të luajnë në edukimin e fëmijëve të tyre, disa prej të cilave përmenden dhe shpjegohen më poshtë.

3.1.1 Prindërit si partnerë

? Çfarë mund të bëjë shkolla dhe mësuesi që prindërit të përmbushin këtë rol?

- Ndhimjnë prindërit për të kuptuar përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre.
- Japin informacion për:
 - rëndësinë që ka ndjekja e shkollës rregullisht nga fëmijët;
 - rregullat dhe procedurat shkollës, duke treguar edhe mënyrat sesi zbatohen ato;
 - programet e shkollës dhe përmbajtjen e fushave të ndryshme kurikulare.

3.1.2 Prindërit si partnerë dhe zgjidhës të problemeve të shkollës

? Çfarë mund të bëjë shkolla dhe mësuesi që prindërit të përmbushin këto role?

- Të sigurojnë materiale dhe të iniciojnë programe apo trajnime, që ndihmojnë prindërit të kuptojnë rregullat dhe procedurat shkollë.
- Të vënë në dukje rëndësinë e komunikimit të prindërve me mësuesit.
- Të vlerësojnë rëndësinë e pjesëmarrjes së prindërve në mbledhjet që organizon shkolla.
- Të iniciojnë programe për t'u mësuar prindërve se si t'i ndihmojnë fëmijët në kryerjen e detyrave të shtëpisë.



3.1.3 Prindërit si vëzhgues

? Çfarë mund të bëjë shkolla dhe mësuesi që prindërit të përmbushin këtë rol?

- Marrin pjesë në planifikimin dhe njoftimin e veprimtarive të shkollës, duke ua bërë të njohura prindërve.
- Bëjnë prindërit pjesë të veprimtarive, si dhe të takimeve që zhvillon stafi mësimor ose klasa.
- Organizojnë veprimtari të ndryshme, duke vendosur një plan të alternuar për orarin, ditët e pushimit dhe pasditet, për t'u dhënë mundësi të gjithë prindërve të ndjekin këto veprimtari.
- Nxisin prindërit që kanë fëmijë nga shtresat në nevojë, fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara ose fëmijë dhe të rinj nga komuniteti rom dhe egjiptian, si dhe prindër që kanë fëmijë me vështirësi në të nxënë, të jenë pjesë e planifikimit dhe e vendimmarrjes, në mënyrë që të jenë pjesë aktive e zgjidhjes.

3.1.4 Prindërit si vullnetarë

Në këtë rol, prindërit punojnë si vullnetarë në ndihmë të shkollës, mësuesve, Bordit të shkollës, Këshillit të prindërve etj. Në shumë praktika të suksesshme ka një traditë që prindërit punojnë vullnetarisht në ndihmë të mësuesve të fëmijëve të tyre dhe të shkollës në tërësi. Nga praktikatat në një nga rrethet janë gjyshet/gjyshërit që janë treguar të gatshëm të ndihmojnë në realizimin e detyrave në shkollë të fëmijët e ciklit të ulët. Kemi prindër me profesione si, për shembull, arkitekt, që kanë rënë dakord që një herë në javë, ditën e premte, nga ora 14:00 - 16:00, të ofrojnë kurse arkitekture dhe Interior Design për nxënësit e gjimnazit.

3.1.5 Prindërit si këshillues dhe partnerë në vendimmarrje

Prindërit japin ndihmesën e tyre në politikën e shkollës dhe planet e programet shkollore nëpërmjet pjesëmarrjes, si në Bordin e shkollës dhe në institucionet vendimmarrëse. Shumë prindër marrin pjesë në Bordin e shkollës, Këshillin e mësuesve, duke krijuar mundësinë që të lidhen me problemet e shkollës dhe veprimtaritë që realizohen aty. Kjo i bën ata që të kenë një autoritet real në vendimmarrje. Sot ka një prirje për t'i përfshirë prindërit në Bordet e shkollës, me synimin që ata të marrin vendime për çështje të ndryshme të shkollës, si dhe për emërimin e stafit mësimor.

3.1.6 Roli i Këshillit të prindërve

Prindërit janë natyrshëm të interesuar që në shkollë të funksionojë gjithçka mirë. Arsimi parauniversitar në Europë shfaq një ndjeshmëri dhe partneritet në rritje të prindërve dhe komunitetit ndaj shkollës.

Pjesëmarrja e prindërve në Bord bën evidente dhe pjesë të zgjidhjes të gjitha shqetësimet e tyre. Është normale që dëshira e tyre të jetë që shkolla të funksionojë maksimalisht, të jetë një "oaz" larg çdo dukurie negative që mbart shoqëria. Duke i bërë partnerë, ata mund të kontribuojnë dukshëm në shkollë.

3.1.6.1 Këshilli i prindërve të klasës

Këshilli i prindërve të klasës jep ndihmesën në përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor për nxënësit e klasës. Ai është një organizëm i cili nxit prindërit të japin ndihmesën e tyre vullnetare, të punojnë me nxënësit me vështirësi në të nxënë, të hartojnë dhe venë në jetë lëndë ose module me zgjedhje, si dhe të bashkëpunojnë për zhvillimin e projekteve kurikulare.

Gjithashtu, Këshilli:

- a) i propozon mësuesit kujdestar përmirësimin dhe mbarëvajtjen e nxënësve të klasës;
- b) dëgjon parashtrimet e mësuesit kujdestar dhe i jep këshilla ose ofron bashkëpunim;
- c) komunikon me prindër të nxënësve që rrezikojnë braktisjen e shkollës ose mbetjen në klasë, ose që kryejnë shkelje të disiplinës.

Këshilli i prindërve të klasës mbledhet një herë në dy muaj, sipas një tematike të planifikuar prej tij ose me propozimin e mësuesit kujdestar. Këshilli mund të mbledhet me nismën e tij edhe më shpesh. Këshilli ka të drejtë të ftojë në mbledhjet e tij mësues të tjerë të klasës, nxënës nga Qeveria e nxënësve, anëtarë të Drejtorisë, të Bordit dhe të Këshillit të prindërve të shkollës. *Kryetari i Këshillit raporton në mbledhjen e përgjithshme të prindërve të klasës, si rregull, dy herë gjatë vitit shkollor.*

Për çdo klasë, brenda 10 ditëve që nga data e fillimit të vitit shkollor, me përkujdesjen e mësuesit kujdestar, zhvillohet mbledhja e përgjithshme e prindërve të nxënësve të klasës, ku zgjidhet, me shumicë votash, Këshilli i prindërve të klasës (3-5 veta). Kryetari i Këshillit të prindërve të klasës zgjidhet prej këtij Këshilli.

Këshilli i prindërve në bashkëpunim me Bordin e shkollës janë struktura që kanë të drejtën të marrin vendime në shkollë dhe në të njëjtën kohë kanë njohjet dhe lidhjet me komunitetin e gjerë të prindërve për t'i mobilizuar ata për çështjet e sigurimit të standardeve cilësore.

Këshilli ka të drejtë t'u drejtohet me propozime për mbarëvajtjen e shkollës Drejtorit të shkollës, Kryetarit të Bordit dhe Kryetarit të Këshillit të prindërve të shkollës.

Udhëzimi përcakton detyra të rëndësishme për Bordin, disa nga të cilat janë risi, si për shembull: përmirësimi i etikës së shkollës.



3.1.6.2 Përmirësimi i etikës së shkollës

Në radhë të parë, Bordi duhet të fokusohet mirë në etikën e shkollës. Të gjithë do ta dëshironim një shkollë perfekte, por ende gjejmë shfaqje që e cenojnë ndjeshëm etikën e shkollës. Dhuna verbale, rrallë edhe ajo fizike, shpërdorime fondesh, kurse private janë dukuri që hasen në shkolla. Kur mendojmë për qytetarët e ardhshëm që edukon shkolla, dëmi është i paimagjinueshëm. Mendoni për një çast të vetëm deformimet që sjellin dhuna, kurset private, presioni i notës etj., në personalitetin e fëmijës. **A ekzistojnë dukuri të tilla në shkollën tonë?**

Është detyrë e Bordit të ndikojë në zhdukjen ose minimizimin e këtyre dukurive dhe në përmirësimin e etikës së shkollës. **Si mund ta realizojë Bordi këtë?**

Në radhë të parë, Bordi vendos se cilën pjesë të etikës së shkollës do të përmirësojë posaçërisht gjatë një viti shkollor. **Si mund ta marrë Bordi këtë vendim?**

3.1.7 Hapa për përmirësimin e kushteve në shkollë dhe lidhja me standardet e ShQK-së

Hapi i parë

Bordi merr informacion.

- Kryetari i prindërve zhvillon një mbledhje me Këshillin e prindërve të shkollës. Secili nga prindërit e tjerë në Bord përzgjedh një klasë dhe fton në mbledhje Këshillin e prindërve të klasës bashkë me prindër të tjerë të asaj klase.
- Në këto mbledhje shtrohet pyetja: “Cili është shqetësimi juaj më i madh në marrëdhëniet e personelit mësimor me nxënësit?”.
- Përfaqësuesit e nxënësve në Bord zhvillojnë mbledhje me Senatin e nxënësve.



? Në këto mbledhje shtrohet pyetja: “Cili është shqetësimi më i madh i nxënësve në marrëdhëniet e personelit mësimor me ta?”.

2 Hapi i dytë

Bordi merr vendim.

- Pasi merr informacion, me shumicë votash, Bordi vendos se cilën pjesë etike të shkollës duhet të ndryshojë sa më shpejt dhe njofton me shkrim Drejtorin e shkollës për vendimin e tij.

3 Hapi i tretë

Bordi miraton planin e posaçëm të Drejtorit për anën etike të shkollës

- Drejtori i paraqet me shkrim Bordit planin e posaçëm për anën etike të shkollës. Plani rishikohet nga Drejtori derisa Bordi ta miratojë atë.

Një tregues i suksesit të Bordit është përmirësimi i thellë i anës etike të shkollës.

Të gjitha këto diskutime mund të kryhen gjatë kohës që analizohen treguesit në standardet e ShQK-së.

Idealja e bashkëpunimit trepalësh nxënës - mësues - prindër do të dukej si fotografia e mëposhtme.

3.1.8 ZËRI DHE VEPRIMI I SHTETASIT



Pra, siç vihet re, ShQK-ja nuk mund të funksionojë e ndarë nga komuniteti. Përkundrazi, rëndësinë parësore e ka zhvillimi dhe angazhimi i komunitetit, ndërkohë është në fokus të veçantë zhvillimi dhe ngritja e kapacitetit të stafit pedagogjik, si dhe rritja e performancës së nxënësve.

Në kapitullin në vijim do të gjeni formën dhe mënyrën e plotësimit të portalit të ShQK-së.

3.1.9 Përmirësimi i shërbimeve dhe influencimi i politikave

Një pjesë e konsiderueshme e standardeve të ShQK-së lidhen drejtpërdrejt me përmirësimin e infrastrukturës shkollore, krijimin e hapësirave sportive dhe kreative në shkolla.

Në ligjin 139/2015 për vetëqeverisjen vendore, përgjegjësitë për standarde infrastrukturore cilësore dhe mirëmbajtje janë pjesë e punës së pushtetit vendor (bashkive), si më poshtë:

Neni 23

Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike

11. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale. 12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Një pjesë shumë e rëndësishme e këtij ligji mundëson përfshirjen e grupeve të interesit, që mund të jenë dhe nga shkollat, për t'u bërë pjesë e vendimmarrjes aktive (buxhetim me pjesëmarrje), si një e drejtë ligjore e çdo qytetari.

Për zbatimin e nismave të ShQK-së, që lidhen me pjesën e kontributit të njësisë administrative dhe të Bashkisë, individëve dhe grupeve në shkolla, vijnë në ndihmë nenet si më poshtë:

Neni 16

Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore

1. Organet e vetëqeverisjes vendore **janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.**

2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatoren për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.

Neni 18

Seancat e këshillimeve me bashkësinë

2. Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, **si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse** ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.

Neni 20

E drejta e iniciativës qytetare

1. Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë, **ka të drejtë të paraqesë për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.** Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe e miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak.

2. Propozimet e ardhura në këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrtohen në këshill, sipas rendit të ditës, dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

KREU XII

FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE KOMUNITARE NË BASHKI, Neni 68 Struktura komunitare në qytet

1. Në qytete, në bazë të iniciativës qytetare, ngrihen dhe funksionojnë këshillat komunitarë të lagjeve. Këshillat përbëhen nga banorë të lagjes dhe organizohen mbi baza vullnetare.
2. Këshillat bashkiakë përcaktojnë rregullat e përgjithshme të organizimit e të funksionimit të këshillave komunitarë të lagjeve dhe marrëdhëniet që ata kanë me bashkinë dhe strukturat e saj.
3. Nga radhët e anëtarëve të këshillave komunitarë zgjidhen ndërlidhësit komunitarë, që drejtojnë dhe organizojnë punën e këshillave.
4. Si rregull, në çdo lagje krijohet një këshill komunitar. Këshilli bashkiak mund të vendosë që në një lagje të krijohen më shumë se dy këshilla komunitarë ose bashkimin e këshillave të dy apo më shumë lagjeve.

Neni 70

Struktura komunitare në fshat

1. Fshati drejtohet nga kryetari dhe kryesia e fshatit. Kryesia është organ këshillimor i kryetarit. Anëtarët e kryesisë së fshatit zgjidhen në mbledhje të fshatit, ku marrin pjesë jo më pak se gjysma e banorëve me të drejtë vote. Përbërja e kryesisë së fshatit duhet të respektojë ligjin për barazinë gjinore. Mënyrat dhe rregullat e votimit përcaktohen nga këshilli bashkiak përkatës.
2. Numri i anëtarëve të kryesisë së fshatit përcaktohet nga këshilli bashkiak në bazë të numrit të banorëve të fshatit dhe lagjeve përbërëse të tij.
3. Kryetari i fshatit zgjidhet nga kryesia e fshatit, nga radhët e anëtarëve të kryesisë së fshatit.
4. Zgjedhjet e kryesisë së fshatit bëhen një herë në katër vjet, pas zgjedhjeve për këshillin bashkiak dhe jo më vonë se tre muaj pas këtyre zgjedhjeve. Në rast mosrespektimi të këtij afati, deri në zgjedhjen e kryesisë së fshatit, kryetari i bashkisë emëron përkohësisht kryetarin e fshatit. Në rastet e krijimit të vendit vakant për anëtar të kryesisë zhvillohen procedurat e sipërpërmendura të zgjedhjes për vendin vakant. Mandati i të zgjedhurit të ri vazhdon deri në përfundim të periudhës së mbetur të afatit katërvjeçar.
5. Procesi i zgjedhjes dhe veprimtaria e kryesisë së fshatit mbikëqyren nga këshilli bashkiak përkatës.

Neni 79

Mbledhjet e hapura, seancat e këshillimeve dhe e drejta e publikut për t'u informuar

Këshilli i qarkut zhvillon mbledhje të hapura për publikun, zhvillon seanca këshillimi me organet përfaqësuese e ekzekutive të bashkive dhe me bashkësitë përkatëse, si dhe respekton të drejtën e publikut për t'u informuar.

Një mënyrë që mund të ndihmojë komunitetin shkollor të paraqesë nismën për përmirësimin e kushteve të shkollës, është pikërisht dokumentimi dhe lidhja që bëhet dhe me procesin e ndjekur në analizën e portalit.

Në seksionin më poshtë do të gjeni përshkrimin për mënyrën e përdorimit të portalit të ShQK-së.

4. Funkionimi i portalit të ShQK-së: shqk.edu.al

Hapim një nga browser-at (Mozilla ose Google Chrome) dhe shkruajmë url: shqk.edu.al (figura 1)



Figura 1

Në hapësirën ku lexon *Akses portali* vendosim kredencialet e shkollës (figura 2):
Username (përdoruesin) dhe password-in (fjalëkalimin):



Figura 2

Pasi logohemi me sukses do të shfaqet hapësira e punës, si më poshtë (figura 3).



Figura 3

Në anën e majtë të ndërfaqes janë të listuara menu-të:

- **Home**

Hapësira në të cilën shkolla mund të ngarkojë (*upload*) informacione (fotografi, materiale në lidhje me aktivitetin e ShQK-së). Upload-i (ngarkimi i informacionit) realizohet duke klikuar butonin: *Shto Dokument*

The screenshot shows a form titled "Shto Dokument" with a close button in the top right corner. The form contains three input fields: "Titulli" (Title), "Pershkrim" (Description), and "Dokument" (Document). The "Dokument" field has a "+ Choose" button. At the bottom left of the form is a "Ruaj" (Save) button with a floppy disk icon.


Plotësojmë të dhënat (titullin, pershkrimin), zgjedhim dokumentin ku është i lokalizuar dhe më pas klikojmë *Ruaj*. Dokumenti do të listohet në tabelë.

- **Plotëso pyetësin**

Pjesa në të cilën shkolla plotëson formularin. Kjo është pjesa ku mësuesi koordinator hedh të dhënat përfundimtare të dalta nga tri grupet e vlerësimit në shkollë.

The screenshot shows a survey form titled "Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënës". It has a sub-header "Përbushja e nevojave dhe interesave të nxënësve". The form contains two sections with 10-point scales. The first section is "Shkolla nxit veprimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve për çështje që lidhen me suksesin e tyre në shkollë e jashtë saj". The second section is "Nxënësit dhe prindërit marrin pjesë në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të kurrikulës në shkollë". Below the scales is a note: "Prindërit bashkëpunojnë me stafin e shkollës në të njëjtën mënyrë të njërit të nxënësve".

- **Aplikimet.** Aplikimet janë të listuara në formë grafike. Vlerat për çdo fushë janë të paraqitura në një grafik dhe gjenerohen automatikisht.



- **Plan pune**

Pasi plotëson me sukses formularin, kalon te Plani i punës, ku do t'i shfaqet edhe fusha e cila ka vlerën me të vogël (si më poshtë):

- ▾ Angazhim dhe zhvillim i komunitetit : 45
 - Franja e prindërve në shkollë :
 - Shkollia ofron zhvillim për komunitetin :
 - Krijimi i kushteve që mundësojnë zhvillim të përbashkët :
 - Financimi i kurseve që ofrohen për komunitetin dhe nga komuniteti :
 - Prindërit janë të përfshirë në planifikimin, menaxhimin, vlerësimin, implementimin dhe aprovimin e programit në oraret jashtë shkollore :

Plani i punës

Veprimtari	Qellimi	Afate	Personat përgjegjës	Burimet	Fusha	Shkollia	Qyteti	Status
No records found.								

(1 of 1) Shto Veprimtari

Për të shtuar një veprimtari, klikojmë butonin *Shto veprimtari*:

Krijo Veprimtari ✕

Veprimtari	<input type="text"/>	Personat Përgjegjës	<input type="text"/>
Materialet	<input type="text"/>	Fusha	Fusha 1 ▼
Qellimi	<input type="text"/>	Afatet	<input type="text"/> 📅
Komente	<input type="text"/>		

Ruaj

Pasi klikojmë Ruaj, veprimtaria do të listohet në tabelën e Planit të punës.

- **Ndrysho kredencialet**

Pasi klikojmë menu-në Ndrysho kredencialet, shfaqet tabela e mëposhtme:

Edit

Shkolla: ██████████

Perdoruesi: ██████████


Fjalekalimi:

Fjalekalimi i ri:

Perserit fjalekalimin:

dhe kemi mundësi të ndryshojmë fjalëkalimin.

- Shkarko formularin





Ky udhëzues synon të lehtësojë procesin vlerësimit të shkollës në kuadër të Shkollës Qendër Komunitare.

Rëndësia e bashkëpunimit prindër – nxënës – mësues – komunitet është çelësi i suksesit të Shkollës Qendër Komunitare.